



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MENDIME MBI PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË  
LIGJIN NR. 79/2017, “PËR SPORTIN”

Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017, “Për sportin”, Ju paraqes sa më poshtë:

**A. Referuar nenit 2 të projektligjit**

Ndryshimet në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2017, “Për sportin”, paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr.	Tematika	Si është në ligjin 79/2017	Si propozohet të bëhet
<b>Neni 2</b>			
1	Ndryshim i pikës 5 të nenit 7 të ligjit 79/2017	<i>5. Ndhimat apo sponsorizimet me materiale dhe pajisje sportive për organizatat sportive shqiptare, të cilat vijnë nga institucione ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar, përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.</i>	<i>5. Ndhimat apo sponsorizimet me materiale sportive, pajisje sportive, <b>barna dhe pajisje mjekësore në funksion të sportit</b>, për organizatat sportive dhe <b>për Qendrën e Shërbimit të Sportit</b>, të cilat vijnë nga institucione sportive ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar, përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. <b>Importi i barnave dhe i pajisjeve mjekësore të dhuruara bëhet me autorizim të veçantë të strukturës përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.</b></i>
	Ndryshim i pikës 6 të nenit 7 të ligjit 79/2017	<i>6. Procedurat e përjashtimit dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.</i>	<i>6. Procedurat e përjashtimit dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive dhe ato <b>mjekësore në funksion të sportit</b> miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.</i>

Siç shihet në tabelën më sipër, **propozimet për ndryshim** në pikën 5 të nenit 7 të ligjit 79/2017 “Për sportin”, janë si më poshtë:

1. **Barnat mjekësore** në funksion të sportit;
2. **pajisjet mjekësore** në funksion të sportit;

Importi i tyre bëhet me **autorizim të veçantë** të strukturës përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

### 3. Qendra e Shërbimit të Sportit.

1. Në lidhje me **barnat mjekësore**, ato **nuk kanë efekt financiar në buxhetin e shtetit**, pasi janë përjashtuar nga detyrimi për TVSH, sipas ligjit “Për TVSH “, **neni 51, pika b.** Por, ne e kemi vendosur në projektligj për t’i dhënë akses Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si **institucion i veshur me ligj**, për të kontrolluar dhe miratuar listën e barnave që mund të importohen për qëllim të mjekësisë sportive (të dhurura nga sponsorë apo donatorë ndërkombëtarë), sipas procedurave për importimin e barnave (të dhurura, të autorizuara dhe të paautorizuara) të parashikuara në **ligjin nr. 105/2014** “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, nenet 21<sup>1</sup>, 32/3<sup>2</sup> dhe 33/3<sup>3</sup>.

Pra, **ndryshimet në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”**, vijnë si reflektim i procedurave të ndjekura më sipër për të bërë ndryshime në vendimin aktual të Këshillit të Ministrave.

2. Në lidhje me **mjekësinë sportive**, aktualisht ky sektor lë shumë për të dëshiruar. Mjafton të themi se sot nuk ka asnjë mjek të licencuar sportiv.

Në maj 2018, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë hartoi projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin nr. 306, datë 24.5.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së materialeve dhe pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar dhe procedurat e përjashtimit”, të ndryshuar”, dërguar për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 5446 prot., datë 17.05.2018.

Në përgjigje të kësaj shkrese, **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, me shkresën nr. 9998 prot., datë 05.06.2018 “*Dërgohet mendim për një projektvendim*”, **shprehet se:**

*“Lidhur me përfshirjen në listën e materialeve dhe pajisjeve sportive të Kreut XXXIII, në të cilin është parashikuar si subjekt përfitues “Agjencia e Shërbimit të Sportit (Mjekësia sportive), si dhe janë përfshirë në listë materiale dhe pajisje mjekësore, **nuk jemi***

---

<sup>1</sup> **Neni 21** - Barnat e dhuruara, mostrat promociionale dhe spitalore

*Ndalohet tregtimi i barnave të dhuruara, i mostrave promociionale dhe spitalore, të cilat mbartin shenjën dalluese, në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre.*

<sup>2</sup> **Neni 32** - Importi i barnave të autorizuara

*3. Verifikimi i barnave të importuara bëhet pranë ambienteve të subjektit, në prani të inspektorit farmaceutik.*

<sup>3</sup> **Neni 33** - Importi i barnave të paautorizuara

*3. Importi i barnave të dhuruara bëhet me autorizim të veçantë të strukturës përgjegjëse për farmaceutikën në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.*

**dakord, pasi, Agjencia e Shërbimit të Sportit (Qendra e Shërbimit të Sportit) nuk bën pjesë në rrethin e subjekteve përfituese të përjashtimit nga detyrimet doganore dhe TVSH. Gjithashtu, materialet mjekësore nuk janë në objektin e përjashtimeve të parashikuara në këtë dispozitë ligjore.”.** (shkresa e MFE bashkëlidhur)

Nga ana tjetër MASR vlerëson se mjekësia sportive është një prioritet i veçantë, duke pasur në konsideratë edhe trajtimin që ka ky segment në arenën ndërkombëtare, dhe si e tillë mbulon një aktivitet të domosdoshëm në drejtim të përparimit të sportit kah niveli kulminant.

Përfshirja e pajisjeve mjekësore në funksion të sportit në lehtësirat doganore dhe TVSH siguron një rrjedhë normale të aktiviteteve sportive dhe rezultojnë me të dhëna shumë të dobishme në funksion të përmirësimit të cilësive fiziologjike tek sportistët.

Mjekësia e sportit paraqet një shtyllë të domosdoshme me rastin e kontrollit shëndetësor, testimave dhe kualifikimit të sportistëve për të plotësuar kushtet e pjesëmarrjes në aktivitete sportive si dhe për të vlerësuar rezultatet e arritura sportive nëse ato kanë qenë konform rregullave dhe dispozitave të aplikueshme e të pranuar ndërkombëtarisht.

Ndërkombëtarizimi i sportit, kërkon krijimin e kushteve për paraqitje dinjitoze në arenën ndërkombëtare dhe sjell si detyrim realizimin e testeve për garat zyrtare. Sigurimi i pajisjeve mjekësore për antropometri dhe rehabilitim, pajisjeve për sektorin e fiziologjisë së sportit dhe laboratorin muskular janë të domosdoshme.

Në këtë drejtim mendojmë se strukturës përgjegjëse, **Qendra e Shërbimit të Sportit**, që ky ligj i ka njohur kontrollin mjekësor me aparaturën e nevojshme me qëllim për të bërë të obliguara kontrollimet mjekësore për të gjithë sportistët dhe klubet sportive që garojnë në kuadër të federatave të licencuara të sportit, t’i mundësohet lehtësimi nga detyrimet doganore për pajisjet mjekësore në funksion të sportit.

3. Në lidhje me **Qendrën e Shërbimit të Sportit**, referuar nenit 45 të ligjit 79/2017 “Për sportin”, kryerja, të paktën, **2 herë në vit**, e matjes së parametrave jetësorë të sportistëve nga mjekë të licencuar, **si kusht** që sportistët të anëtarësohen në federatë dhe të marrin pjesë në veprimtari sportive, veçanërisht **sportistët e ekipeve kombëtare**, është **procedurë obligative për Qendrën e Shërbimit të Sportit**.

#### **Ligji 79/2017 “Për sportin” - Neni 45 - Kontrolli mjekësor në sport**

1. *Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në një federatë dhe të marrë pjesë në veprimtari sportive të organizuara prej saj pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e anëtarësuar pajisen me kartelë mjekësore vetjake.*

2. *Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të licencuar, **të paktën një herë në gjastë muaj**, për matjen e parametrave jetësorë. Sporte të veçanta, për natyrën e veçantë të tyre, parashikojnë në rregulloret e funksionimit kontrole mjekësore më të shpeshta.*
3. *Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare **bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Qendrës së Shërbimit të Sportit** dhe Përgatitjes së Ekipeve Kombëtare.*
4. *Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.*

**Efektet financiare** të këtij propozimi paraqiten në tabelën bashkëlidhur:

- Në kolonën “Çmimi referencë i tregut (lekë)” është vendosur çmimi referencë i tregut për efekt të përlogaritjes së kostove që rrjedhin nga detyrimi i TVSH;
- Në kolonën “Vlera (lekë)” është vendosur vlera e përgjithshme e pajisjeve për përdorim 10 vjet. Vlera e përgjithshme = 13.896.000 lekë.
- Në kolonën “TVSH (lekë)” është përlogaritur vlera e përgjithshme e TVSH e pajisjeve për përdorim 10 vjet. TVSH = 2.779.200 lekë = 22.595 Euro
- Duke marrë në konsideratë se pajisjet mjekësore kanë **afat përdorimi jo më të vogël se 10 vjet**, (paraqitur në kolonën “Sasia - Përd. mbi 10 vjet”), është përlogaritur kosto vjetore e TVSH (paraqitur në kolonën “Kosto që rrjedh nga TVSH/VJETORE”) dhe mujore (paraqitur në kolonën “Kosto që rrjedh nga TVSH/MUJORE”)

Sikurse shihet në tabelë, **kostot që rrjedhin nga TVSH janë 22.595 euro/10 vjet, ose 2,260 euro/vit, ose 188 euro/muaj.**

**Si përfundim**, mendojmë se propozimi i paraqitur, nëpërmjet ndryshimit të pikave 5 dhe 6 të nenit 7 të ligjit 79/2017 “Për sportin”, ofron një mundësi për mbulimin e shpenzimeve për pajisjet mjekësore në funksion të sportit me sponsorizime nga organizata/organizma ndërkombëtare, në të kundërt, nëse ky projektligj nuk miratohet, i mbetet **Buxheti të Shtetit** për të financuar Qendrën e Shërbimit të Sportit, financim i domosdoshëm për të realizuar detyrat që rrjedhin nga ligji 79/2017 “Për Sportin”, respektivisht neni 45, pikat 1, 2 dhe 3.

## **B. Referuar nenit 1 dhe nenit 4 të projektligjit**

Në projektligj përfshihet për herë të parë koncepti i “**Kartës së Tifozit**”, i cili përbën një marrëveshje ndërmjet tifozëve dhe organizatës sportive. Në kartën e tifozit do të përcaktohen, të drejtat dhe detyrimet e organizatës sportive ndaj tifozëve të saj, si dhe anasjelltas, sanksionet lidhur me rastet e shkeljes së kësaj marrëveshjeje, si dhe rregulla lidhur mbi mbarëvajtjen e veprimtarisë sportive brenda dhe jashtë vendit.

**Neni 1** parashikon përkufizimin e termit “Karta e tifozit”, si më poshtë:

*Pas pikës 7, të nenit 3, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:*

*“7/1. “Karta e tifozit”, është një marrëveshje ndërmjet tifozëve dhe organizatës sportive, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatës sportive ndaj tifozëve të saj, si dhe anasjelltas, sanksionet bazë lidhur me rastet shkeljes së kësaj marrëveshjeje, si dhe rregulla lidhur me mbarëvajtjen e veprimtarisë sportive, brenda e jashtë vendit.”.*

Karta e Tifozit erdhi si rezultat i ndryshimeve në Kodin Penal për dhunën në sport (**neni 274/a, neni 274/b**), duke synuar përcaktimin e rregullave të qarta për organizatat sportive (federatat) dhe ndjekësit e tyre, me qëllim parandalimin dhe ndalimin e dhunës në futboll dhe aktivitete të tjera sportive, në **përputhje me Konventën Evropiane** “Për një qasje të integruar për rendin, sigurinë dhe shërbimin në ndeshjet e futbollit dhe aktivitetet e tjera sportive”, të miratuar në parim me vendimin nr. 853 të Këshillit të Ministrave datë 23.05.2018.

**Neni 4** parashikon përmbajtjen dhe procedurën për lëshimin e “Kartës së tifozit”, si më poshtë:

*Pas nenit 21 shtohet neni 21/1, me këtë përmbajtje:*

**“Neni 21/1**

**Karta e tifozit**

- 1.Karta e tifozit lëshohet nga organizata sportive, pas anëtarësimit të tifozit, sipas llojit të veprimtarisë sportive që kjo organizatë ushtron.*
- 2. Karta e tifozit përmban rregulla lidhur me çështjet e anëtarësisë, konsultimin dhe informimin, aksesin dhe përdorimin e stadiumeve, sigurinë dhe mbrojtjen e spektatorit, tregtimin lidhur me shitjen e biletave, aktivitetet e adresuara komunitetit, si dhe rregulla të tjera, kundër racizmit, dhunës, ksenofobisë apo diskriminimit në futboll.*
- 3. Rregulla lidhur me procedurën dhe mënyrën për pajisjen me kartën e tifozit përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizatës sportive.”.*

### **C. Referuar nenit 3 të projektligjit**

**Neni 3**

*Pas nenit 13 shtohet neni 13/1, me këtë përmbajtje:*

**“Neni 13/1 - Mbështetja financiare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore**

*Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të mbështesin me financime klubet e tyre përkatëse sportive të futbollit të superligës, vetëm në rast se të gjithë futbollistët e klubit e kanë pagën mujore jo më të vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë (bruto).”.*

**Nuk kam asnjë informacion mbi këtë propozim (nuk është propozim i MASR).**

Në përfundim, kërkojmë miratimin e këtij projektligji.

Faleminderit!